



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

**th ë r r e t**

mbledhjen e **pestë** të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **27.6.2024** dhe do të fillojë në orën **12:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. "UÇK", nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024;
3. Propozim-vendimi për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027 (KAB);
4. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të projektdokumentit: Projekt-Plani i zhvillimit komunal 2024-2032 (PZHK);
5. Propozim-vendimi për ndryshimin e ri-parcializimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (te banimi individual) të planit rregullues Prishtina e Re zona perëndim, dhe ndrrimin e destinimit të BLL.I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë;
6. Projektkodi i etikës për zyrtarët e Kryeqytetit;
7. Propozim-vendimi për përkrahje financiare të klubeve sportive të Kryeqytetit dhe Eventit sportiv 3x3 Prishtina;
8. Propozim-vendim për themelimin e Komisionit të Kuvendit lidhur me shfrytëzimin e Banesave të Komunës së Prishtinës në Bregun e Diellit, Fusha e Pajtimit dhe në Hajvali;

9. Raporti i përgjithshëm i punës për Ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtinë;
10. Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-060/01-77958/24, më 18.6.2024

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina



---

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 381(0)38/230-900  
<http://ëëë.pristina-komuna.org>